

20211031639

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË PUNËSIMIT DHE TË
SIGURIMIT NË RAST TË PAPUNËSISË

Neni 1

Në Ligjin e Punësimit dhe të Sigurimit në Rast të Papunësisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 37/97, 25/2000, 101/2000, 50/2001, 25/2003, 37/2004, 4/2005, 50/2006, 29/2007, 102/2008, 161/2008, 50/10, 88/10, 51/11, 11/12, 80/12, 114/12, 39/14, 44/14, 113/14, 56/15, 129/15, 147/15, 154/15, 27/16, 119/16, 21/18 dhe 113/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 124/19), pas nenit 98-x shtohet nen i ri 98-i siç vijon:

“Neni 98-i

(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori i punës përcakton se punëdhënësi, përkatësisht personi përgjegjës në personin juridik ka kryer kundërvajtje të përcaktuar sipas nenit 99 të këtij ligji, është i detyruar për kundërvajtjen e kryer të përpilojë procesverbal, në pajtim me ligjin dhe me aktvendimin e punëdhënësit, përkatësisht personit përgjegjës në person juridik t’i shqiptojë masë inspektuese - vërejtje dhe t’i përcaktojë afat në të cilin është i detyruar t’i eliminojë parregullsitë dhe mangësitë e përcaktuara.

(2) Nëse pas kalimit të afatit të përcaktuar gjatë shqiptimit të vërejtjes sipas paragrafit (1) të këtij neni, inspektori i punës konstaton që parregullsitë dhe mangësitë ende nuk janë mënjanuar, me aktvendim shqipton urdhër për mënjanim të parregullsive dhe mangësive të konstatuara.

(3) Aktvendimi sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni, miratohet menjëherë, ndërkaq më së voni në afat prej tetë ditëve nga përpilimi i procesverbalit, në pajtim me ligjin.

(4) Kur gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese nuk janë konstatuar parregullsi dhe shkelje të tjera të ligjit apo ndonjë dispozite tjetër apo parregullsitë e konstatuara janë mënjanuar gjatë mbikëqyrjes inspektuese ose në afatin e përcaktuar me aktvendimin sipas paragrafit (1) të këtij neni, inspektori i punës e ndërpret procedurën, me konstatim në procesverbal në pajtim me ligjin.

(5) Me përjashtim të paragrafit (3) të këtij neni, inspektori i punës mund të shqiptojë masë inspektuese me aktvendim me gojë, të shënuar në procesverbal në pajtim me ligjin.

(6) Në rastin sipas paragrafit (5) të këtij neni, inspektori i punës është i obliguar menjëherë, por më së voni në afat prej tetë ditëve, të miratojë aktvendim me gojë për shqiptim të masës inspektuese, në pajtim me ligjin.

(7) Kundër aktvendimit sipas paragrafëve (1), (2) dhe (6) të këtij neni, mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve nga pranimi i aktvendimit, në organin kompetent për vendimmarrje në shkallë të dytë, në pajtim me ligjin.

(8) Ankesa nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit sipas paragrafëve (1), (2) dhe (6) të këtij neni.

(9) Për vërejtjet e shqiptuara, Inspektorati Shtetëror i Punës mban evidencë, në mënyrë të përcaktuar nga ministri kompetent për punët nga fusha e punës.“

Neni 2

Neni 99 ndryshohet dhe bëhet:

“(1) Gjorbë në shumë prej 800 deri 1.200 euro me kundërvlerë në denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtje punëdhënësit - person juridik, nëse:

- ndërmjetësimi për punësim kryhet me kushte dhe mënyrë në kundërshtim me nenet 26 deri 46 të këtij ligji;

- punëdhënësi nuk e paraqet çdo themelim të marrëdhënies së punës dhe çdo pushim të marrëdhënies së punës (neni 51 i këtij ligji);
 - punëdhënësi nuk e çregjistron punëtorin menjëherë pas pushimit të marrëdhënies së punës (neni 60 i këtij ligji) dhe
 - punëdhënësi nuk llogarit dhe nuk paguan kontribut për punësim (neni 97 i këtij ligji).
- (2) Gjobë në shumë prej 250 deri 350 euro me kundërvlerë në denarë i shqiptohet për kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni personit përgjegjës në personin juridik.
- (3) Për kundërvajtjet e paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni procedurë kundërvajtëse mban edhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.”.

Neni 3

Neni 100 ndryshohet dhe bëhet:

- “(1) Gjobë në shumë prej 200 deri në 250 euro në kundërvlerë në denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar në Agjenci, nëse:
- nuk e shpall fletëparaqitjen e nevojës për punëtorë në Agjenci (neni 7 paragrafi 2 të këtij ligji);
 - ndërmjetësimin gjatë punësimit e kryen me kushte dhe mënyrë në kundërshtim me nenet 26 deri në 46 të këtij ligji;
 - nuk e paraqet çdo themelim të marrëdhënies së punës dhe çdo pushim të marrëdhënies së punës (neni 51 i këtij ligji) dhe
 - fut në evidencë të personave të papunësuar, person të papunësuar para kalimit të afatit të përcaktuar në këtë ligj (nenet 56, 57 dhe 58 të këtij ligji).
- (2) Gjobë në shumë prej 100 deri 150 euro me kundërvlerë në denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni drejtorit.
- (3) Gjobë në shumë prej 30 deri në 50 euro në kundërvlerë në denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar të autorizuar i cili e udhëheq procedurën, nëse:
- nuk i grumbullon dëshmitë në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës (neni 27-a paragrafi 3 dhe neni 74 paragrafi 4 të këtij ligji) dhe
 - nuk vendos për kërkesën në afat prej 30 ditësh nga pranimi i kërkesës (neni 80 paragrafi 3 të këtij ligji).
- (4) Gjobë në shumë prej 30 deri 50 euro në kundërvlerë në denarë, do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar të autorizuar nga organi publik kompetent nga i cili janë kërkuar dëshmitë dhe të dhënat nëse nuk i dorëzon dëshmitë dhe të dhënat e kërkuara në afat prej tri ditësh nga pranimi i kërkesës (neni 27-a paragrafi 4 dhe neni 74 paragrafi 5).
- (5) Për kundërvajtjet e paragrafëve (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni procedurë kundërvajtëse mban edhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente.

Neni 4

Neni 100-a ndryshohet dhe bëhet:

- “(1) Inspektori i punës para se të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtjen sipas neneve 99 dhe 100 të këtij ligji, është i detyruar personit përgjegjës ose personit të autorizuar nga ai të punëdhënësi t’i lëshojë urdhërpagesë për kundërvajtje, në pajtim me Ligjin e Kundërvajtjes.
- (2) Nëse kryerësi e paguan gjobën në afat prej tetë ditësh nga dita e lëshimit të urdhërpagesës për kundërvajtje, do ta paguajë gjysmën e gjobës së paraparë, por nëse nuk e paguan në afatin e paraparë, personi zyrtar i autorizuar do të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse në gjykatën kompetente.
- (3) Formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës për kundërvajtje i përcakton ministri kompetent për punët nga fusha e punës.”.

Neni 5

Në nenin 100-v në paragrafin (1) fjalët: “dhe mandatore pagesore” fshihen.
Paragrafi (4) fshihet.

Neni 6

Neni 100-g fshihet.

Neni 7

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi të këtij ligji.

Neni 8

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të përcaktojë tekst të zbardhur të Ligjit të Punësimit dhe të Sigurimit në Rast të Papunësisë.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.